

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me Zyrtaren ligjore Albane Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit G. M. nga fshati D., Komuna e Malishevës, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë PP.nr.773/2017, të datës 30.08.2017, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par. 1 nën paragraf 1.4 të KPRK-së, pas mbajtjes së shqyrtimin fillestar publik më datën 14.01.2019, ku prezent ishin prokuror shtetit Ismet Tofaj, i dëmtuari P. M., si dhe i akuzuari G. M., gjykata më datën 16.01.2019, mori dhe publikisht shpalli këtë:

AKTGJYKIM

I akuzuari:

G. M., nga i ati B., e ëma M., e gjinisë A., i lindur më datë ..., në fshatin D., Komuna e Malishevës, ku edhe tani jeton, i martuar i ati i ...fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, me numër personal ..., shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Me datën 16.04.2017, në fshatin D., Komuna e Malishevës, tjetrit i shkakton lëndime të lehta trupore më dëmtim te përkohshëm të shëndetit ashtu që ditën kritike rreth orës 16:30 min, gjersa po lëvizte me automjet, hap derën e veturës me qëllim që ta lëndoj të dëmtuarin P. M., i cili po ecte rrugës dhe në pamundësi goditjeje pasi i dëmtuari largohet disa metra, i pandehuri ka dal jashtë veturës dhe me një sëpatë të vogël i është matur për ta goditur dhe pasi nuk arrin krijohet një përleshje me duar mes tyre, në atë mënyrë i shkaktohet lëndime të lehta të dëmtuarit konstatuar sipas ekspertizës mjekoligjore të ekspertit Dr. N. H., e dt. 14.06.2017.

-me këtë ka kryer veprën penale të lëndimi i lehtë trupor nga neni 188 par 1 nën paragraf 1.4 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 46, 49, 51,52, 73, 188 par. 1 nën paragraf 1.4 të KPRK-së si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të njëjtit i shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarin G. M., e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej pese (5) muaj i cili dënimin nuk do ta ekzekuton në afatin prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari që të në emër të paushallit gjyqësor, gjykatës t'ia kompensojë shumën prej 30 euro, dhe ekspertizën mjeko-ligjore në shumen prej 20 euro në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari P. (H.) M., nga fshati D., Komuna e Malishevës, udhëzohet që kërkesën pasurore juridike ta realizojnë në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, pranë kësaj gjykate ka paraqitur aktakuzë PP.nr. 773/2017, të datës 30.08.2017, kundër të akuzuarit G. M. nga fshati D., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par 1 nen paragrafi 1.4. të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar dhe ka mbajtur shqyrtimin fillestar me dt. 14.01.2019, dhe pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, të pandehurit iu dha mundësia për ta pranuar fajësinë apo të deklarohet i pafajshëm.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar, me vullnet të plotë dhe i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë, e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së prokurorisë së shtetit.

Pas deklarimit të pandehurit se ndjehet fajtor për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet nga Prokuroria, gjykata me Aktvendim pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që është bindur plotësisht se ishte i vetëdijshëm për pasojat e pranimin të fajësisë.

Prokurori i shtetit jep mendimin se nuk e kundërshtojnë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit që është bërë ashtu siç është përshkruar në dispozitivet e aktakuzës dhe së pranimin e fajësisë e kam mbështetur edhe provat materiale të cilat gjinden në shkresat e lëndës, kërkoj nga gjykata me rastin e caktimit të dënimit të ketë parasysh merren rrethanat lehtësuese.

I dëmtuari deklaron, se nuk kërkoj që të dënohet G. M., nuk kërkoj kompensim e dëmit jemi familjarë, kamë dëshire që të mbyllet kjo seancë, pasi që ka ndodhur rastësisht dhe nuk kemi pasur asnjë problem deri më sot.

I pandehuri G. M., deklarohej i fajshëm për akuzën, e kam bërë pa qëllim, më vjen keq që e kam bërë dhe kur kam shkuar në polici kamë quajtur më ka ardhur turp, i kërkoh falje për veprën penale, dhe nuk do ta përsëris asnjëherë veprën penale pasi që kurrë unë nuk kam qenë në gjykatë.

Nga thëniet e vet të pandehurit në shqyrtimin e fillestar u vërtetua se ai me datë, kohën dhe vend si në dispozitivin e aktakuzës së ngritur ndaj tij ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Po ashtu nga shkresat e lëndës dhe nga provat materiale siç janë: Njësia e Forenzikës me di. 16.04.2017, DN-.; Raporti fillestar i incidentit nr. i rastit ..., i dt. 16.04.2017; Raporti policor mbi marrjen ne pyetje të dyshuarit/ pandehurit G. M. dhënë në Stacionin Policor në M.me nr.... i dt.16.04.2017; Raporti policor mbi marrjen ne pyetje e të dyshuarit/ pandehurit P. M. dhënë në Stacionin Policor në M., me nr..... dt.16.04.2017; Foto dokumentacioni; Vërtetimi mbi konfiskimin e sendeve dt. 16.04.2017; Raporti i oficerit nr....., të dt.16.04.2017; Raporti Mjekësor nga Q. M., me nr.... të dt.16.04.2016; Ekspertiza e ekspertit mjeko-ligjore Prof. asoc. dr. N. H..

Gjykata me pranimin e fajësisë nga i pandehuri ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore që pranimi i fajësisë të aprovohet nga ana e gjykatës. Gjykata ka pranuar deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri dhe vlerëson se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet edhe figura në tërësi e veprës penale që ka kryer i akuzuari, andaj mbi këtë bazë edhe gjykata i ka vlerësuar këto prova dhe deklarin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar si të tillë.

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 dhe 74 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë, sidomos për faktin se është hera e parë që ndeshet me ligjin mos ndëshkueshme ia e tij e mëparshme, i pa pune, at i p. fëmijëve, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, Gjykata të akzuarit i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej pese (5) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej një (1) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor, është marr komfor nenit 450 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendosë si në diapozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/ DEGA MALISHEVË
P.nr.289/2017, të dt. 16.01.2019

Zyrtarja ligjore
Albane Morina

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Njazi MORINA

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme.